

Livino

VERË 2025

NR. 54

Në
FERMËN *e*

*Luana
Sjollcës*



Në FERMËN e Luana Vjollcës

Është një ditë mesqershori dhe në “Ferma VIP” bën nxehtë. Jo vetëm sepse temperaturat kanë shkuar mbi 30 gradë celsius, por edhe sepse po afron finalja. Gjakrat janë ndezur, çka duket edhe nga reagimet në rrjetet sociale. Emocionet dhe ethet nuk kanë mbërthyer vetëm fermerët, por edhe bejleren, Luana Vjollcën. Po këto ethe janë ndryshe nga ato të pak muajve më parë, kur nisi kjo aventurë. Janë më tepër ethe lumturie në fund të një udhëtimit të bukur, i cili erdhi në një moment kur asnjë projekt tjetër nuk ia mbushte syrin. Kishte disa alternativa në tryezë dhe thauja e kishte marrë një vendim për një projekt që nuk e frymëzonte dhe as e sfidonte, si natyrë që kërkon përherë sfida të reja. Me “Fermën” ra menjëherë në dashuri dhe tha me gjithë shpirt “po”. “Me ‘Fermën’ ndodhi diçka interesante, - kujton Luana. - Kur m’u bë propozimi mendova menjëherë se ishte oferta e duhur në atë moment. Nuk më mungon intuïta për të kuptuar në çast nëse diçka ia vlen apo jo dhe ndjeva se kjo ishte sfida e re që po kërkoja prej kohësh. **Si natyrë më pëlqejnë projektet sfiduese, më bëjnë të ndihem e gjallë dhe ta jetoj me emocion çdo ditë.**”

RECIPIETA • AMINNA STORE // GCDS
BUST • AMINNA STORE // LOEWE
PANTALLONAT • AMINNA STORE // PRADA
VETHET • SWAROVSKI, QENDRA METROPOL



NGA GENTIAN MINGA
KRYEREDAKTORE: SANTANA ÇOMORA
REDAKTORE: ETLEVA ÇEPELE
FOTOGRAFIA: ENDRIT MËRTIRI
FASHION EDITOR: NIKO KOMANI
GRIMI: HENRI GJATA
FLOKËT: FLORI HAIRSTYLE
EDITORE: XHOIA DUMI
DESIGN & LAYOUT: EDI BUJARI

« Njeriu e kupton kur një stad i caktuar i jetës është ezauruar dhe nuk mund të shkojë më tej. **E në kësi rastesh, unë zgjedh gjithmonë t'ia nis nga e para**»



CROP TOP • LULU BY LUANA
STRECE • LULU BY LUANA
UNAZAT • SWAROVSKI, QENDRA METROPOL
SANDALET • GUCCI

Emocione më se të dukshme çdo herë që shfaqet në ekranin e Vizion Plus. Në fakt, grintën dhe entuziazmin për televizionin Luana e ka pasur që ditën e parë që nisi këtë rrugëtim. Më kujtohen fillimet e saj. Mua më kanë lënë mbresa, sepse kam qenë gazetari i parë që jo thjesht e ka intervistuar, por së bashku me velinën tjetër, Livian, i kam nxjerrë dhe në kopertinën e “Intervistës”, gazetës më të shitur të fundjavës asokohe. Rreth 17 vjet më parë. Edhe pse vetëm 16 vjeçe, Luana e dinte mirë se çfarë po bënte. Dha një intervistë interesante. Pozoi si modele përpara aparatit fotografik. Gazeta “Intervista” atë numër ka shkuar për së dyti në print brenda javës. Që atëherë i lexohej në sy natyra e vendosur, ambicioze dhe dëshira për t'i bërë vetes një vend në botën e televizionit. Dhe ia doli. Nuk do të kalonte shumë kohë para se të shndërrohej në sensacion, një nga moderatoret dhe autoret më të suksesshme të emisioneve *prime time* në ekranet kombëtare. Ndalesa e radhës, “Ferma VIP”, përvojë që po e sfidon, por dhe e argëton. “Ishte pikërisht momenti për t'u sprovuar në një format tjetër televiziv”, - shprehet ajo.

Për Luanën, t'ia nisësh nga e para është dhuratë. Një mundësi për t'u rritur, për t'u zhvilluar. Sidomos nëse aty ku je nuk ke hapësirë të rritesh më tej. Qoftë në lidhje, në punë, apo në çdo aspekt të jetës. “Njeriu e kupton kur një stad i caktuar i jetës është ezauruar dhe nuk mund të shkojë më tej. E në kësi rastesh, unë zgjedh gjithmonë t'ia nis nga e para”, - thotë Luana. Si dikush që po bën një ndryshim rrënjësor në karrierë e po ia nis edhe vetë nga e para, i kam parasysh pasiguritë, dyshimet dhe frikën e së panjohurës, ndaj ajo që do të thoshte Luana më pas, më ngrohu. “Sido që të shkojë, dalim të fituar: nëse ndryshimi del për mirë, rritemi, nëse dështojmë, prapë fitojmë, sepse mësojmë nga gabimet dhe pa gabime nuk zhvillohemi dot.”



TOP • LULU BY LUANA
BODY • ADIDAS
KORSE • LULU BY LUANA
JACKET • ADIDAS
STRECE • LULU BY LUANA
VARESE • SWAROVSKI, QENDRA METROPOL

Në FERMËN e Luanës

“Ferma” e Luanës i ka të gjitha kafshët: tigrat e egër që sulmojnë, mjellmat e bukura dhe elegante, kameleonët që ndryshojnë sipas rastit, macet lojcake, gjarpërinjtë helmues, arushët gjumashë, hienat. Sigurisht, nuk mungon mbretëresha e “Fermës”, luane-sha, e cila, sado e egër, e rrezikshme dhe me të papritura të jetë “Ferma”, gjithmonë ia del. Të kuptohemi, t’ia dalësh nuk do të thotë të mos kesh frikë, por të kesh guxim, të luftosh dhe të dalësh mbi frikën.

Shqetësimi më i madh qëndron te fakti se formati i “Fermës” është diçka e panjohur për të. Ndonëse përvoja me *reality show*-t nuk i mungon dhe sapo ka lënë pas një sezon të suksesshëm të një *reality*, sfida mbetet se ky format kishte të bënte edhe me fshatin. “Mbah mend vetëm një moment kur kam qenë e vogël, që shkoja në fshat te gjyshja nga ana e mamit. Kam kujtime të ëmbla, të bukura nga fshati, por të zbehta”, - tregon. Megjithatë, edhe pse këtë format e drejton nga studioja dhe jo nga ferma, sërish arrin ta marrë energjinë që vjen nga toka dhe natyra. Falë natyrës lojcake e batutave, arrin të shkrihet natyrshëm me realitetet që jeta në fshat e fermerëve sjell edhe në skenën nga ku mbahet drejtpërdrejt spektakli.

Edhe pse një *reality show* si “Ferma” ka përmasa gjigante, gjithçka bëhet më e lehtë kur ke një sistem mbështetës dhe staf profesionist për të përballuar ngarkesën. Ndryshe nga projektet e mëparshme, kur Luana është kujdesur vetë për gjithçka, nga fillimi deri në fund, te “Ferma” nuk është autore. Për këtë spektakël punon një grup i madh profesionistësh. Autore, kryeredaktorë, redaktorë, producentë e teknikë me në krye njeriun që pati idenë për të bashkëpunuar në këtë projekt dhe që ajo i është falënderuese për gjithë punën e palodhur, qytetarinë e dëshmuar dhe vizionin për ta çuar para këtë sezon të dytë, me të gjitha kushtet ndërkombëtare për një projekt cilësor gjigant televiziv. Formati po ashtu, në vetvete ka një bibël që duhet respektuar deri në pikën e fundit. “Në formatet e tjera që kam drejtuar, pjesa më e madhe e punës bëhej në prapaskenë, - thotë Luana. - Punonim gjithë javën për të ndërtuar skaletën në mënyrën më të përpiktë, të kishim të ftuarit më të mirë, të krijonim përmbajtjen që do të na sillte dinamika në program, ama sapo

» Puna e vërtetë nis kur dal në skenë.

Pikërisht atëherë duhet t’i kem shqisat të mprehta, që të mos më shpëtojë asgjë e t’i menaxhoj siç duhet situatat që krijohen live. «



dilja në skenë, e dija se lodhjen e kisha lënë pas dhe shijoja programin. Te ‘Ferma VIP’ ndodh e kundërta. Patjetër që aty punohet 24 orë në 24, por ecuria e programit diktohet nga ajo çka japin konkurrentët *live* dhe si zhvillohen dinamikat, gjë që nuk e kontrollojnë dot me skaleta paraprake. Pra, puna e vërtetë nis kur dal në skenë. Pikërisht atëherë duhet t’i kem shqisat të mprehta, që të mos më shpëtojë asgjë e t’i menaxhoj siç duhet situatat që krijohen *live*.”

Për të thënë të drejtën, te “Ferma” ka plot për të menaxhuar. Situatat janë dinamike e të paparashikueshme. Po ashtu, ka një konflikt të brendshëm, qasjen ndaj të cilit, si Luana, edhe producentët, e kanë ndryshe nga pjesa tjetër e tregut mediatic. Të gjithë e dimë se ajo që shet në ekran, sidomos në programet *reality show*, janë sherret, debatet, shpesh banaliteti. Po qasja që ka

KANOTIERE • AMINNA STORE // DOLCE & GABBANA X SKIMS
STRECE • AMINNA STORE // DOLCE & GABBANA X SKIMS
BADANA • SOUVENIR STORE TIRANA

“Ferma” është një tjetër: që programi të ecë përpara pa debate apo sherre banale, por me një frymë qytetarie. Edhe pse debatet në një *reality show* nuk shmangen dot plotësisht, producentët dhe autorët e “Fermës VIP” kanë bërë maksimumin që gjërat të shkojnë sa më qetë dhe shfaqja të reflektojë qytetari.

Menaxhimi i situatave është i stilit “tërhiq e mos këput”. Luana nuk është e njëjta gjithë kohën. Ka raste kur tregohet më e rreptë se sa duhet me konkurrentët, kur shkelin ndonjë rregull të formatit, për shembull. Pastaj ka raste kur tregohet më e butë se ç’duhet dhe përpiqet ta qetësojë situatën. “Prirja ime është t’i sheshoj gjërat, në vend që ta bëj qimen tra, të ushqej sherret e t’i hedh konkurrentët kundër njëri-tjetrit”, - thotë. Kjo zgjedhje mund të tingëllojë e gabuar kur bëhet fjalë për një format që synon shikueshmëri. “Ne e dimë se shikueshmërinë programeve ua garantojnë sherret e debatet, por mendoj se publiku është inteligjent dhe, nëse i ofron diçka të mirë, me kohën do të fillojë ta kërkojë. Sidoqoftë, unë nuk shkoj dot kundër parimeve të mia për disa klikime më shumë.”

Ashtu si edhe në jetë, Luana nuk do energji negative në ekran. Gjithë stresin preferon ta kalojë përpara se të dalë *live*. Me t’u ndezur dritat e kamerave, nuk ka më vend për drama. Ajo shndërrohet në një fëmijë të lumtur, e sheh televizionin si lojën e saj të preferuar dhe e shijon në maksimum. Pas kuintave është serioze. Shumë më kërkuese. Shumë më strikte. Në skenë? E hapur vetëm për t’u argëtuar. Për të bërë batuta. Për ta jetuar çastin. Dhe për ta shijuar shfaqjen në maksimum.

Diçka tjetër interesante që po i ndodh te “Ferma VIP” është se për herë të parë po i kushton rëndësi të veçantë pamjes së jashtme. Natyrisht, gjithmonë është kujdesur të duket bukur. Kjo ndoshta për faktin se falë përvojës tashmë ka fituar më tepër vetëbesim kur bëhet fjalë për prezantimin, skenën, teksa dikur ka pasur pasiguritë e veta dhe energjinë më të madhe e kanalizonte te performanca, përmbajtja dhe të dilte sa më profesionale para publikut. Tani do që *look*-un ta ketë në përsosmëri. “Shumë njerëz do të habiten kur ta lexojnë këtë, pasi pamja ime ka qenë që prej fillimit shumë e përfolur, por e vërteta është që për një kohë të gjatë *look*-un e kam cilësuar si diçka as të dorës së dytë

jo, por të dorës së tretë fare. Qëllimi dhe e gjithë puna ime përqendrohej te prezantimi, skaleta, skenari, montazhi... Doja që në anën profesionale të ishte gjithçka perfekte”, - thotë Luana.

Vëmendja ndaj pamjes i ka dhënë frytet edhe në këtë kopertinë. Fotografitë plot stil të Endrit Mërtirit janë prova. Stafit me të cilin ka punuar në set ka arritur të nxjerrë thelbin e saj, qoftë si drejtuese e “Fermës VIP”, qoftë kur bëhet fjalë për brendin “Lulu by Luana”. Kryeredaktorja e revistës “Living”, Santana Çomora, *fashion editor*-i Niko Komani dhe editorja Xhoia Dumi kanë zbritur në setin e fotografive plot dy ditë për të realizuar disa nga fotografitë më të bukura të Luanës kohëve të fundit. Roza e ëmbël në disa prej tyre është qartazi simbol i koleksionit më të fundit të “Lulu by Luana”, atij *Sunset Rose*.

Meqë jemi te “Lulu”, ky brend që mban firmën e Luanës do të jetë ndalesa e radhës në këtë bisedë, sepse ka shumë për të thënë. Teksa “Ferma VIP” është drejt fundit, me finalen e madhe më 20 qershor, “Lulu” është në pikun e saj. “Në fund të rrugëtimit te ‘Ferma VIP’ ndihem e lumtur, e përmbushur, - i vë Luana kapakun këtij kapitulli të bisedës. - Jam në një fazë të jetës kur mundohem t’i shijoj gjërat, pasi kam kuptuar se janë të përkohshme. Dua t’i marr më të mirën asaj që më sjell jeta e të mos ndalem përballë asnjë dashakeqësie apo energjie negative që mund të ofrojë. Këtë zgjedh ta bëj kudo, në jetë e në skenë, ndaj shpesh momente të tilla mundohem t’i kaloj me të qeshur, si për të thënë: ‘Ju lutem, të jemi më pozitivë.’”

Kur flitet për “Ferma VIP”, nuk mund të mos e pyesja Luanën edhe për një kuriozitet që e kanë shumë njerëz: a do të kishte pranuar ndonjëherë të merrte pjesë në këtë format, por kësaj here si fermere? Pas një të qeshure të gjatë, e cila në fakt është një përgjigje, ajo thotë: “S’e imagjinoj dot veten si konkurrenente. Sado që jam natyrë e hapur me publikun, spontane, e vërtetë dhe i dua kamerat, kur vjen puna te jeta private, te gjërat e mia, jam e ngurtë. Nuk ndaj dot gjithçka me njerëzit.” Nuk e përfytyron dot veten të monitoruar 24 orë në kamera. “Do të kishte qenë çudia më e madhe, po të ndodhte, por do të kishte qenë bukur, sepse i kam zili fermerët për përvojën dhe gjithçka të re që po mësojnë e po përjetojnë në ‘Ferma VIP 2’!”

» **Jam në një fazë të jetës kur mundohem t’i shijoj gjërat, pasi kam kuptuar se janë të përkohshme.** Dua t’i marr më të mirën asaj që më sjell jeta e të mos ndalem përballë asnjë dashakeqësie apo energjie negative që mund të ofrojë. «

FUSTANI • LULU BY LUANA
KORSE • LULU BY LUANA
AKSESORET • SWAROVSKI, QENDRA METROPOL



LULU *by Luana* VETËBESIMI ËSHTË GJITHCKA

Të gjitha vajzat dhe gratë e botës së spektaklit rreken të zhvillojnë një sipërmarrje, për të përkthyer në njëfarë mënyre popullaritetin dhe fuqinë e tyre në atë që është pushteti më i madh sot: biznesi. Por jo të gjitha kanë sukses. Edhe nëse ia dalin, shpesh idetë e tyre janë të zakonshme. Ajo që më pëlqen më shumë në rastin e Luanës është se nuk ka shkuar aty ku shkojnë të gjitha: te veshjet, kozmetika, produktet klasike të bukurisë. Për të eksploruar dimensionin e saj si sipërmarrëse ka zgjedhur një produkt të veçantë dhe unik, për të cilin nuk ka konkurrencë: korsetë.

Kjo ide biznesi i rri mirë, është zgjedhje e sinqertë. Luana më tregon se janë pikërisht korsetë sekretit pas belit të saj të hollë, kaq i përfolur ndër vite. Ka provuar modele e brende nga më të ndryshmet, nga të gjitha vendet e botës dhe e ka korsënë element jetik të daljes në ekran. Mirëpo kjo përvojë e gjatë e ka ndihmuar të kuptojë se ku qëndronte problemi me çdo brend dhe kështu i lindi një ide, që më pas u kthye në plan e mandej në biznes: si të krijonte korsënë e përsosur. Si "vajza e korseve", ky mision i rrinte më së miri.

Sapo ka lançuar koleksionin e ri, atë rozë, dedikuar vajzave që janë më shumë sesa *Barbie*, dhe deri tani janë bërë publike vetëm dy korse. "Korseja 'Lulu' është një milion herë më e mirë se ato që kam mbajtur vetë ndër vite. Kam provuar korsetë e gjithë botës, nga brende të ndryshme, por si korseja 'Lulu' nuk ka! Kam punuar shumë që ta realizoj në përsosmëri, sepse dua që kur ta veshin, vajzat të ndihen të bukura e plot vetëbesim, - thotë Luana. - Gjithashtu, kam një problem që e kanë edhe shumë vajza të tjera: dhembjen e shpinës. Me siguri krijuar nga vitet me orë të gjata qëndrimi në skenë, me taka të larta, por korseja e gjatë të ndihmon edhe në ruajtjen e posturës, që të mos kesh dhembje, ndaj vjen deri në pjesën sipër të shpinës, për të të mbuluar paksa 'tulet', por edhe për të të mbajtur shpinën në *comfort* e pa dhembje. Unë për vete, kur jam në skenë, e kam shumë të vështirë të qëndroj në këmbë nëse nuk e kam korsënë LULU veshur."

FUSTAN • MULTIBRAND, ARENA / JACQUEMUS
KORSE • LULU BY LUANA
AKSESORËT • SWAROVSKI, QENDRA METROPOL
KEPUCËT • GUCCI

» Kam provuar korsetë e gjithë botës, nga brende të ndryshme, por si korseja 'Lulu' nuk ka! **Kam punuar shumë që ta realizoj në përsosmëri, sepse dua që kur ta veshin, vajzat të ndihen të bukura e plot vetëbesim.** «





» Nuk e kam fjalën për vetëbesimin tekanoz e arrogant, por për dashurinë ndaj vetes. **Për një vajzë që e di se kush është dhe herët a vonë edhe bota do ta marrë vesh.** «

Brendi "Lulu by Luana" sigurisht që ka lidhje me mendësinë e një vajze të pavarur. Për t'u treguar vajzave se vjen një moment kur i realizon gjërat që dëshiron, por ka gjithmonë më shumë, ndaj nuk duhet të ndalesh. "Në këtë moment të jetës mund të më shikojnë si të realizuar dhe pyesin veten se për çfarë i jam futur punës për të hapur një biznes. Po sipërmarrja ka qenë një nga sfidat më të mëdha me të cilat më është dashur të përballem, pasi nuk kisha fare njohuri rreth saj. Kjo është një dhunti që ta jep Zoti dhe rrugës kam zbuluar se kam nerva ta bëj mirë edhe këtë punë." Natyrisht, sfidat kanë qenë të mëdha. Aq sa i janë dashur plot katër vjet punë që të nxjerrë në dritë brendin "Lulu by Luana", si detajiste e perfeksioniste që është.

"Lulu by Luana" përfaqëson një vajzë me vetëbesim të jashtëzakonshëm, që pavarësisht nga format trupore ndihet rehat me veten dhe i qaset botës me vetëbesim. Bukuria e vërtetë e një vajze qëndron te vetëbesimi. Po e pate atë, nuk ka gjë që nuk e arrin dot. Megjithatë, e ndjen të nevojshme të bëjë një saktësim. "Nuk e kam fjalën për vetëbesimin tekanoz e arrogant, por për dashurinë ndaj vetes. Për një vajzë që e di se kush është dhe herët a vonë edhe bota do ta marrë vesh."

Pasioni i Luanës për një produkt të tillë të veçantë kushtuar vajzave e grave, nuk është rastësi. E rritur në një botë vetëm me vajza, të cilave u dashur të mbijetojnë e të tregojnë veten, ajo nuk e sheh dot ndryshe gruan, përveçse si të fuqishme dhe rehat nën lëkurën e saj.

"Thuaje" me zë më të lartë

I kam intervistuar disa herë ndër vite Marinën dhe Luanën. Ajo që kam vënë re, jo vetëm unë, por edhe shumë kolegë, është lidhja e fortë midis motrave Vjollca dhe mamasë së tyre. Një lidhje e bukur. Jo të gjithë, por gjithsesi shumë njerëz, e njohin historinë e tyre. Kjo lidhje ndoshta vjen për shkak të mënyrës se si motrat Vjollca janë rritur. "Kemi pasur vetëm njëra-tjetrën. Kjo temë më emocionon gjithmonë, deri në pikën sa më humbasin fjalët, - thotë Luana. - Jemi shumë të lidhura, ndoshta sepse na ka munguar figura mashkullore, që të na bënte të ndiheshim të sigurt,

SETI LEOPARD • ADIDAS
CROP TOP • LULU BY LUANA
PINK CROP TOP • LULU BY LUANA
KORSE • LULU BY LUANA



» Jemi shumë të lidhura, ndoshta sepse na ka munguar figura mashkullore, që të na bënte të ndiheshim të sigurt, të mbrojtura. **Kemi qenë të gjitha vajza e jemi rritur me frymën që, në rast se ndonjëra rrëzohej, të tjerat të ishim aty për ta pritur.** «



TOP • LULU BY LUANA
CROPPED JACKET • ADIDAS
FUNDI • LULU BY LUANA
CANTA • ADIDAS
KAPELE • ADIDAS
AKSESORET • SWAROVSKI, QENDRA METROPOL

» Doja shumë që influenca që kam, të shërbejë sadopak për të ndihmuar **në fuqizimin e atyre që kanë nevojë për një zë më shumë.** «

të mbrojtura. Kemi qenë të gjitha vajza e jemi rritur me frymën që, në rast se ndonjëra rrëzohej, ne të tjerat të ishim aty për ta pritur.”

Dhe sigurisht, në familjen e tyre, lidhja midis Marinës e Luanës do të duhej të ishte paksa më e veçantë, ngase i bashkon më shumë puna në televizion. Një marrëdhënie e tillë, ku ka edhe garë, edhe tifozllëk. Me garë nuk nënkuptoj botën e televizionit, të sqarohemi, por atë se kush është e preferuara e mamit. “Nuk do t’ju gënjej, dikur ka qenë Marina, por këto vitet e fundit jam unë”, - thotë Luana duke qeshur. Mendon madje se e di edhe arsyen. Ndoshta ngase mungon shumë në shtëpi dhe mamin e merr malli. Sa herë e ëma e merr në telefon, është e zënë. Ka një punë në dorë. Është diku (në xhirime, i bie). Ndaj dhe mami e sheh me dhembshuri, sepse është gjithë kohën e ngarkuar dhe e lodhur. “Në publik nuk e tregojmë kurrë anën tonë të keqe. Sa të lodhur, të ngarkuar e të dobët ndihemi ndonjëherë. Me mamin i ndaj të gjitha këto emocione, sepse është gjiri i ngrohtë ku jam njëqind për qind vetvetja. Në rast se puna nuk ka shkuar mirë, dita ka qenë e mbrapshtë apo jam e pakënaqur për ndonjë arsye, nëse nuk kam arritur apo nuk kam marrë atë që dua, te mami përplasem.”

Vajzat Vjollca tashmë ndodhen në një vend të mirë në jetën e tyre, por nuk ka qenë gjithmonë kështu. Jeta për nënën e tyre, një zonjë me katër vajza dhe pa mbështetje, ka qenë sfidë. Ka qenë ndoshta kjo arsyeja pse pak vite më parë Luana vendosi të ndërmerre nismën “Thuaje”, një fushatë për fuqizimin e vajzave dhe grave. “Ngacmimin e parë e kam marrë nga mami. Një grua e vetme në një shoqëri patriarkale. Ka qenë pikënisja e interesit tim për temën e grave. Jemi rritur përmes shoqatës ‘Gra pa përkrahje’ asokohe, dedikuar grave pa bashkëshort, siç ishte mami. Pra, nisur nga vetja, ajo krijoi një shoqatë prej së cilës u rritëm. Kam dashur ta rikthej në një formë apo tjetrën punën dhe kontributin e saj në kauzën për të drejtat dhe fuqizimin e gruas, edhe pse, sigur-



isht, kjo që bëj nuk mund të krahasohet me punën e jashtëzakonshme të mamit. Pastaj u futa thellë në botën e sfidave që një grua e vetme has në jetë. Kam dëgjuar histori të dhimbshme, kam biseduar me shumë vajza e gra”, - thotë Luana.

Në ato dy vite mund të kishte bërë televizion apo të merrej me ndonjë gjë fitimprurëse, sepse ofertat nuk i mungonin, por vendosi t’i përkushtohej fushatës “Thuaje”, edhe pse nuk kishte ndonjë përfitim. “E dimë se projekte të tilla nuk sjellin klikime apo përfitime personale, por unë doja shumë që influenca që kam, të shërbejë sadopak për të ndihmuar në fuqizimin e atyre që kanë nevojë për një zë më shumë, - thotë dhe shton se kjo nismë ka qenë gjithmonë një investim personal. - Jam krenare për ‘Thuaje’ dhe do ta vazhdoj. Kisha një objektiv kur e nisa dhe kam një vizion se ku dua të shkoj me të.”

» **S'e imagjinoj dot
veten si konkurrenente.**

Sado që jam natyrë
e hapur me publikun,
spontane, e vërtetë dhe
i dua kamerat, kur vjen
puna te jeta private,
te gjërat e mia, jam e
ngurtë. Nuk ndaj dot
gjithçka me njerëzit. «
